

SOLIDARIZOHEMI



ME NJËRI-TJETRIN

RESPEKTIMI I LIGJEVE

JON B. (13), JON S. (12), ARBEN (12), EDONIS (12), BESMIR (12), OLIKS (12), LYRA (12), YLLKA (13)



Po të mos ishin ligjet, të drejtat tona nuk do të merreshin parasysh. Se si ndikojnë këto ligje në jetën tonë, iu ftojme ta lexoni këtë artikull, të cilin e kemi shkruar me shumë përkushtim

Arditi është nxënës i shkollës fillore „Zekeria Rexha“, në klasën e VII-të. Një ditë duke shkuar në shkollë ai pa një mace, e cila ishte e lënduar. Ai e mori macen dhe e dërgoi tek veterinari. Arditi çdo ditë pas mësimit shkonte në veterinari dhe shikonte punën e veterinarit. Atij i pëlqente shumë puna që ai bënte. Pasi u shërua macja, ai bisedoi me veterinarin për punën e tij dhe e pyeti për arritjet në profesionin që kishte. Veterinari i tregoi Arditi se puna e veterinarisë është e arritshme, duke mësuar dhe duke qenë i angazhuar. Po ashtu, i tregoi se për shkak që jetojnë në një vend demokratik, ata të gjithë e gëzojnë të drejtën e shkollimit, si dhe të drejtën për të zgjedhur edhe profesionin.

Ky ishte një shembull se çfarë na ofron neve demokracia dhe se si ne duhet të jemi të përgjegjshëm si qytetarë, duke u angazhuar për të arritur një qëllim të caktuar.

Njashtu, në demokraci kemi edhe shumë të drejta të tjera, si: e drejta e familjes, e drejta e strehimit, e drejta e kujdesit shëndetësor, etj. Të gjitha këto të drejta, ne i kemi të garantuara me ligj. Vendimet për ligje merren në institucionin më demokratik dhe shumë të rëndësishëm, i cili është Kuvendi.

Prandaj, Kuvendi ndryshe njihet edhe si Pushteti Leg-

jislaviv, sepse aty bëhet pikërisht miratimi i ligjeve nga deputetët, të cilët janë edhe përfaqësuesit e popullit.



Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi, elemente të demokracisë



Bashkohuni me ne



Rëndësia e edukimit qytetar në demokraci




Jemi të barabartë ngado që shkojmë




Procesi zgjedhor, baza e demokracisë përfaqësuese



Vota e secilit ka vlerë të madhe



Mjetet informuese, mëse të nevojshme për zhvillimin tonë



Gjykatat merren me vendosjen e drejtësisë në vend



Jemi ne populli ata që vendosim për të ardhmen tonë. Prandaj, përgjegjësia jonë është që të votojmë

ZGJEDHJET DHE RËNDËSIA E TYRE

KLEVIS (12), ARIAN (12), VESA (12), DIAN (12), ALINA (12), BLENDAR (14), XHAVID (13), ARDENIS (12)



Ata të cilët votojnë, janë qytetarë aktiv

Para dy vjetësh, mësuesja jonë erdhi në klasë me disa broshura në duar. Të gjithë ishim të habitur kur ajo u ul në bankën e saj dhe filloi të na shpjegonte se çfarë përmbajnë ato broshura. Pasi na shpërndau të gjithëve broshurat, e kuptuam se nga 4 alternativa që ishin aty, ne duhej të zgjedhnim lëndën zgjedhore, që do ta mbajmë në klasën e VI-të. Ishte e vështirë ta bëjmë një zgjedhje të tillë, pasi që po e bënim këtë lloj zgjedhje për herë të parë. Shumica e klasës votoi për lëndën e informatikës dhe si përfundim, lëndë zgjedhore jonë u bë lënda e informatikës.

Në shkollën tonë, çdo vit mbahet një festë për nder të ditës së shkollës sonë. Aty mbahen disa pika vallëzimi, këndimi, recitimi, etj. Mësuesja jonë shkoi në çdo klasë dhe zgjodhi disa nxënës për vallëzim. Ne filluam ushtrimet e para të vallëzimit dhe pas disa kohësh u ndamë në grupe. Çdo grup përbëhej nga tre persona. Nga secili grup, mësuesja zgjodhi nga një përfaqësues. Kjo që ka bërë mësuesja jonë, quhet zgjedhje. Një ditë, arsimtarja e teknologjisë, na tha që do të duhet të përgatisim një projekt për këtë lëndë. Ne të gjithë u angazhuam që të bënim projekte sa më të bukura në mënyrë që punimet tona të merrnin pjesë në Panairin e Shkencës në qytetin tonë. Në klasë nxënësit erdhën me punime të mrekullueshme. Megjithatë, fatkeqësisht arsimtarja duhej t'i zgjedhte tre punimet më të bukura. Ajo e kishte të vështirë të zgjedhte, por

në fund të orës, ajo i mori punimet e përzgjedhura dhe e përfaqësoi klasën tonë në Panairin e Shkencës. Arsimtarja me të vërtetë bëri një zgjedhje të mrekullueshme.

Të gjitha këto janë raste, në të cilat ne vetë i kemi përjetuar, e të cilat kanë të bëjë me zgjedhjet. Ne kemi edhe zgjedhje, të cilat janë më të rëndësishme për shtetin tonë. Ato janë zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Zgjedhjet lokale janë zgjedhje, në të cilat qytetarëve u jepet mundësia të votojnë për të parin e komunës, pra, kryetarin. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore, qytetarët votojnë për deputetët.

Meqenëse kemi shumë të drejta në demokraci, ne duhet t'i shfrytëzojmë këto të drejta. E njëra prej tyre është e drejta e votës mbi moshën 18 vjeçare. Duke votuar, ne bëhemi edhe qytetarë aktiv.



Ne do ta kryejmë përgjegjësinë tonë si qytetarë, duke votuar

MEDIA NË BOTËN E DEMOKRACISË

ERIKA (12), ERA(12), KURBIN (12), LEZI JAN (12), VLERA (12), RRON (13), PLATIN (12)



Media, pushteti i katërt, i cili po sjell ngritje të vetëdijes qytetare

Investimi në ngritjen e vetëdijes qytetare është proces mjaft i rëndësishëm në krijimin e një shoqërie mend-jehapur. Kësaj ngritje është duke i paraprirë pushteti i katërt, i cili njihet si media.

Media luan rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e një demokracie të mirëfilltë. Përmes saj, populli është në linjë me ngjarjet më të reja që ndodhin në vend.



Edhe radio bën pjesë në media elektronike

Përfitimi nga media e shkruar dhe elektronike nuk ka çmim. Përmes medias jemi në hap me kohën. Prandaj, informimi i drejtë dhe i saktë duhet të jenë pjesë e pandashme e medias.

Edhe ne nxënësit jemi përfitues të asaj çka ofron media. Ne marrim informata të cilat janë shumë të rëndësishme, por, çdoherë tregohemi të kujdesshëm në përzgjedhjen e tyre. Zakonisht, informatat që ne i

marrim kanë të bëjnë me të dhënat më të reja për shtetin tonë. Na pëlqejnë edhe kuriozitetet, por pse jo, edhe të dijmë se çfarë ndodh në botë dhe rajon.

„Biblioteka më e madhe në botë gjendet në kryeqytetin amerikan Washington. Kjo bibliotekë u ndërtua në 24 prill 1800. Në të gjenden 107 milionë shkrime të të gjitha arteve“. Ky është një nga kuriozitetet që kemi mësuar kohët e fundit. Të tilla informata marrim çdo ditë dhe gjatë kërkimit në internet, mundohemi të gjejmë informatat më të sakta.

Prandaj, ju ftojmë të gjithë juve, të cilët jeni pjesë e medias që të jeni të kujdesshëm me publikimet që i bëni. Veprimet tuaja mund të kenë ndikim të madh tek të tjerët. Ne, qytetarët e kemi lirinë për t'u shprehur, andaj nëse ju keni dëgjuar raste të ngacmimit përmes internetit, ju ftojmë që t'i adresoni ato tek organet kompetente. Së bashku e ndërtojmë një shoqëri demokratike dhe me vlere.



Me publikimet tona, ne bëhemi pjesë e medias



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Zekeria Rexha“
Klasa: VII-2
Vendi: Gjakovë